



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 89, datë 24.09.2024

PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDEVE TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT PËR EFEKT TË RITJES SË PAGAVE TË PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË INSTITUCIONET ARSIMORE DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR, SI DHE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.419, datë 26.06.2024 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, shkresës për alokimin e fondeve me nr.8098/2 prot., datë 25.7.2024 të Ministrisë së Financave, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e shpërndarjes së fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit si transferta sektoriale për efekt të rritjes së pagave për vitin 2024 për funksionin e arsimit parashkollor (edukator

/punonjës arsimor/punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve) dhe funksionin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas tabelës së mëposhtme:

Gr.	Kodi institucionit	Emri institucionit	kapitulli	programi	projekti	llogaria ekonomike	Vlera (në lekë)
Rritja e pagave , arsimit parashkollor (edukatorë/punonjës arsimor/punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve)							
00	2107008	Qendra Ekonomike Arsimit	01	09120	90007AA	600	20,713,000
00	2107008	Qendra Ekonomike Arsimit	01	09120	90007AA	601	4,170,631
00	2107021	Qendra Kulturore Fëmijëve	01	09120	90007AA	600	70,203
00	2107021	Qendra Kulturore Fëmijëve	01	09120	90007AA	601	140,000
							25,093,834
Rritja e pagave , Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi							
00	2107001	Bashkia Durrës (MZSH)	01	03280	90001AA	600	3,833,046
00	2107001	Bashkia Durrës (MZSH)	01	03280	90001AA	601	1,000,000
							4,833,046

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.09.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 545 / prot.

Durrës, më 27.09.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.89 datë 24.09.2024 ,” Për miratimin e detajimit të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit për efekt të rritjes së pagave të punonjësve mësimor dhe punonjësve të tjerë mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar , si dhe të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

